

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7899
E shtunë, 5 tetor 2024
Çmimi 0.50

Mavraj takon Endritin,
tregon mesazhin
që ia kishte dhënë
Thaçi në Hagë | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**EDHE OPOZITA PO PREMTON
SI POZITA DIKUR** F.7

Shkruan:
Behxhet Sh.
SHALA-BAJGORA



AKTUALE



**HARADINAJ: ME AAK-në NË QEVERI,
ISTOGU DO TË SHNDËRROHET
NË PIKËNISJEN E AUTOSTRADËS
SË DUKAGJINIT** F.6

**IKSHPK-ja: UJI I LIQENIT TË
BADOCIT TË MOS PËRDORËT PËR
PIJE** F.6

**PROKURORIA SPECIALE: RIDVAN
MUHARREMI U INTERVISTUA NË
CILËSINË E TË PANDEHURIT** F.7

**OPOZITA, KRITIKA PËR MUNGESË
DHE ÇMIME TË LARTA TË BARNAVE
'DERI NË 400 PËR QIND'** F.6

EKONOMI



**PËRMBARUESI PRIVAT BLOKON
PËRSËRI LLOGARITË E TELEKOMIT
TË KOSOVËS** F.8

**NËSE KA RRIJJE EKONOMIKE, PSE
NUK PO E NDIEJNË QYTETARËT?** F.8

KURTI: PËR SHKAK TË SUKSESIT TONË, BEOGRADI ËSHTË NERVOZ DHE AGRESIV

FAQE 3



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një intervistë për "Bloomberg"-un, ka thënë se për shkak të suksesit të suksesit të institucioneve të shtetit tonë, Serbia është më nervoze dhe

agresive. Ai ka thënë se sa herë ndërmarrin veprime në veri, Serbia alarmohet. "Sa herë që ndërmarrim veprime ka zëra alarmues për përshkallëzimin e mundshëm, por ja ku jemi -

Kosova është më mirë se kurrë më parë", ka thënë Kurti, duke mbrojtur veprimet e tij si të nevojshme për të rivendosur ligjin dhe rendin në veriun e ndarë prej kohësh

**PRESIDENTJA
OSMANI PRITET
NË PARIS NGA
HOMOLOGU
FRANCEZ** F.3



**PROTESTA E
MËSIMDHËNËSVE TË
VITISË, JASHARAJ:
JAVA E ARDHSHME
MUND T'I GJEJË NË
GREVË NËSE NUK U
DALIN PAGAT** F.7



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni: Nuk besoj se do të ketë luftë gjithëpërfshirëse në Lindjen e Mesme

WASHINGTON, 4 TETOR - Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka thënë se beson se një luftë e gjithanshme në Lindjen e Mesme mund të shmanget, duke theksuar se duhet bërë më shumë për të shmangur një konflikt të madh në rajon.

I pyetur nga gazetarët në Uashington, se sa i sigurt është ai se një luftë e gjithanshme në

Lindjen e Mesme mund të parandalohet, Bideni është përgjigjur: "Sa i sigurt jeni që nuk do të bjerë shi? Shiko, nuk besoj atje do të jetë një luftë e gjithanshme. Mendoj se ne mund ta shmangim atë", raporton "Reuters".

Bideni ka theksuar se ShBA-ja është duke biseduar me Izraelin për opsionet për t'iu përgjigjur

sulmit të Iranit ndaj Izraelit, që përfshin sulmin e Izraelit ndaj objekteve të naftës iraniane dhe pas kësaj deklarate të Bidenit, çmimet e naftës janë rritur.

Çmimi i naftës "West Texas Intermediate" është rritur me 5.5 për qind dhe i është afruar çmimit prej 74 dollarësh për fuçi, ndërsa çmimi referencë globale i naftës Brent është rritur rreth 77 dollarë.



Koreja e Veriut kërcënon me armë bërthamore nëse sulmohet

PHENIAN, 4 TETOR - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ka thënë se shteti i tij do të përdorë armë bërthamore "pa hezitar" nëse sulmohet nga Koreja e Jugut dhe aleati i tij, Uashingtoni, ka raportuar media shtetërore verikoreane më 4 tetor.

Raportet në mes të dy Koreve janë në pikën më të ulët në dekada dhe Seuli gjatë kësaj jave mbajti një paradë ushtarake ku shfaqti një raketë të fuqishme që tha se mund t'i godasë bunkerët nëntokësorë të Veriut. Gjatë paradës, presidenti jugkorean, Yook Sun Yeol, ka paralajmëruar Kimin se përdorimi i armëve bërthamore do të nënkuptonte



fundin e regjimit të tij. Nëse forcat e armikut do "ta shkelnin sovranitetin" e Veriut, Pheniani "do të përdorte pa

hezitar të gjitha forcat sulmuese që ka në dispozicion, përfshirë edhe armët bërthamore", ka thënë Kim, sipas agjencisë

shtetërore të lajmeve KCNA.

Sipas fotografive të publikuara nga KCNA-ja, Kim i ka bërë këto deklarata gjatë një trajnimit të forcave për operacione speciale. Ai e ka kritikuar Yoonin për komentin e bërë për "fundin e regjimit" dhe aleancën e Koresë së Jugut me Shtetet e Bashkuara. Seuli, që nuk ka armë bërthamore, është aleat me Uashingtonin, i cili ka stacionuar dhjetëra mijëra trupa në këtë shtet që kur përfundoi lufta koreane më 1953 pa një traktat të paqes.

Kim ka thënë se Seuli dhe Uashingtoni "po shkatërrojnë sigurinë rajonale dhe paqen". Të

martën mbi qiellin e Koresë së Jugut kanë fluturuar avionë luftarakë dhe në rrugë janë shfaqur armë të Koresë së Jugut. Ky shtet për herë të parë ka shfaqur raketën më të madhe balistike që ka, "Hyunmoo-5", e cila është e aftë të shkatërrojë bunkerë nëntokësorë.

Gjatë paradës në qiellin e Koresë së Jugut janë parë edhe bombarduesit amerikanë "B-1B" dhe avionët luftarakë "F-15K". Uashingtoni në mënyrë periodike dislokon asete bërthamore në Gadishullin Korean, duke thënë se vepron kështu për ta mbrojtur Seulin nga kërcënimet në rritje që vijnë nga Pheniani.

ShBA-ja thotë se parandaloi aktivitetet e një grupi rus të hakerëve

WASHINGTON, 4 TETOR - Një grup hakerësh, ilidhur me inteligjencën ruse, është parandaluar nga kryerja e aktiviteteve të tyre, kanë bërë me dije "Microsoft"-i dhe autoritetet amerikane.

Zyrtarët amerikanë kanë thënë se ky grup është përpjekur të futej në sistemet kompjuterike të ish-punonjësve ushtarakë dhe të inteligjencës amerikane, si dhe në ato të organizatave joqeveritare, kompanive amerikane dhe të tjerëve.

Një gjykatë amerikane ka hapur dokumente për ta autorizuar "Microsoft"-in dhe Departamentin Amerikan të Drejtësisë për të sekuestruar më shumë se 100 emra domenesh të lidhura me grupin e hakerëve, i

njohur si grupi "Callisto i Star Blizzardit". "Ky sekuestrim është pjesë e një përgjigjeje të bashkërenduar me partnerët tanë të sektorit privat, për ta shkatërruar infrastrukturën që aktorët e spiunazhit kibernetik e përdorin për t'i sulmuar shënjestrat amerikane dhe ndërkombëtare", ka thënë prokurori i Qarkut Verior të Kalifornisë, amerikani Ismail J. Ramsey.

Grupi kishte në shënjestër individë me e-maile që dukeshin sikur vinin nga një burim i besuar, një taktikë e njohur si "spear phishing", ka thënë Departamenti Amerikan i Drejtësisë në një njoftim për shtyp. Pasi hapeshin linqet brenda këtyre e-maileve,



hakerët përpiqeshin të hynin në sistemet e brendshme të viktimave për të vjedhur të dhëna dhe për t'i penguar aktivitetet e tyre.

Sipas "Microsoft"-it, veprimet e "Star Blizzardit" ishin të vazhdueshme dhe të sofistikuara. Ky grup shpesh bënte kërkime të hollësishme paraprake për këdo që synonte ta sulmonte. "Star

Blizzard", gjithashtu, kishte vënë në shënjestër grupe të shoqërisë civile, kompani amerikane, kontraktues ushtarakë amerikanë dhe Departamentin Amerikan të Energjisë, i cili mbikëqyr shumë programe bërthamore, tha kompania.

Autoritetet nuk kanë dhënë hollësi nëse aktivitetet e "Star Blizzardit" ishin ose jo të suksesshme, por kanë thënë se presin që Rusia të vazhdojë t'i përdorë hakerët për sulmet kibernetike kundër Uashingtonit dhe aleatëve të tij. Shtetet e Bashkuara janë zotuar se do të vazhdojnë të jenë syhapur. "Me mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë të sektorit privat, ne do të jemi të pamëshirshëm në ekspozimin e

aktorëve rusë dhe kriminelëve kibernetikë dhe në privimin e tyre nga mjetet e tregtisë së tyre të paligjshme", ka thënë zëvendësprokurorja e Përgjithshme, Lisa Monaco, në komunikatën e Departamentit të Drejtësisë.

Autoritetet amerikane kanë ngritur aktakuzë ndaj dy burrave rusë vitin e kaluar në lidhje me veprimet e mëparshme të "Star Blizzardit". Të dy besohet se janë në Rusi.

"Star Blizzard" ka sulmuar edhe njerëz dhe grupe në të gjithë Evropën dhe në vendet e tjera të NATO-s, ka thënë Departamenti i Drejtësisë. Shumë prej tyre kishin mbështetur Ukrainën pas pushtimit nga Rusia.

Norvegji, numri i makinave elektrike tejkalon ato me benzinë

OSLO, 4 TETOR - Në Norvegji vendi evropian i pasur me naftë dhe gaz natyror, numri i automjeteve elektrike e tejkaloi atë të automjeteve me benzinë. Sipas të dhënave të shpërndara të Këshillit norvegjez të Informacionit për Trafikun Rrugor, nga 2.8 milionë automjete pasagjerësh të

regjistruara në vend, 754 303 janë elektrike, ndërsa 753 905 janë me benzinë.

Norvegjia është prodhuesi më i madh i naftës dhe gazit natyror në Evropë, me një prodhim ditor të naftës prej 4 milionë fuçi. Përderisa vendi synon të jetë neutral ndaj karbonit në vitin 2030, investimet në këtë fushë

pritet të mbeten në nivel të fortë më 2025, ku këtë vit është realizuar një nivel rekord i investimeve në naftë dhe gaz natyror.

Megjithatë, interesimi ndaj makinave elektrike në Norvegji është në një nivel mjaft të lartë. Gjithashtu, parashikohet se në rrugët e Norvegjisë deri në vitin

2030 do të ketë 3.1 milionë automjete elektrike. Norvegjia ofron lehtësime në tatime në blerjet e automjeteve elektrike. Përderisa Norvegjia ofron lehtësime në tatime në blerjet e automjeteve elektrike, personat që kanë automjete elektrike në shumë lokacione mund ta gjejnë mundësinë e karikimit të



makinave të tyre pa pagesë. Dhjetë nga 9 automjete në vend janë elektrike, ndërsa përdorimi i automjeteve elektrike inkurajohet në çdo fushë.

Përfundoi kursin për instruktor në Bundeswehr, nënoficeri i FSK-së certifikohet në Gjermani

PRISHTINË, 4 TETOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka bërë me dije se rreshteri Bunjanin Raçi ka përfunduar me sukses kursin për instruktor në Bundeswehr.

Në njoftimin e FSK-së është thënë se ai është certifikuar për operimin për "VIP Security and

Escort", përcjellje të personaliteteve me rëndësi të veçantë, me motoçikleta. "Në kuadër të bashkëpunimit me Republikën Federale të Gjermanisë, dhe në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Policisë Ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës, rreshter

Bunjanin Raçi, ka përfunduar me sukses kursin për instruktor në Bundeswehr ku është certifikuar për operimin për "VIP Security and Escort", përcjellje të personaliteteve me rëndësi të veçantë VIP-ve me motoçikleta", ka njoftuar FSK-ja.



Mavraj takon Endritin, tregon mesazhin që ia kishte dhënë Thaçi në Hagë

PRISHTINË, 4 TETOR - Publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka takuar Endrit Thaçin, djalin e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi.

Mavraj në "Facebook" ka treguar se në Hagë, Thaçi ia kishte dhënë një mesazh për Endritin. "Thaçi, në Hagë, kur isha për vizitë, disa herë u shpreh i kënaqur për ecjen e djalit deri atëherë dhe disa herë na ka porositur: Mos ma lini në shoqëri të keqe", ka shkruar Mavraj.

Ai ka publikuar edhe një fotografi të Hashim Thaçit me Endritin kur ishte i vogël.

Ish-kryetari i Kuvendit të Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, Muhamet Mavraj, me rastin e 27-vjetorit të protestave studentore, ka takuar personalitete të ndryshme të cilat kanë dhënë kontribut të çmuar në organizimin e tyre si dhe ka bërë homazhe te vendprehjet e studentëve dëshmorë.



POSTIMI I PLOTË I MAVRAJT:

Sivjet pata shumë dëshirë që për 1 tetor t'i nderojmë pleqtë e Thaçit, por ishte e pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore, në vende të ndryshme. Ata e lindën dhe e rritën një strateg të lirisë. Solidarizohem 100 për qind me ta në vuajtjen për mungesën e përkohshme të tij plot me shpresë se nuk do të na ikin pa u bashkuar në liri së shpejti me të.

Në shenjë simbolike të nderimit

jemi takuar me të birin, fëmija i vetëm, Endritin, dhe me Blerimin, të vëllanë, njeri i jashtëzakonshëm në thjeshtësinë e përrjetshme të tij që i amortizon peshat e rënda me buzëqeshjen e butë kah flet. Model që lind, nuk vjen si kopje.

Endritit, më në fund, ia dhurova një album me 14 fotografi që ai kurrë nuk i ka parë as ka ditur gjë për to: ato të ditës së parë të shkollës (1 shtator 2005), prej tyre edhe kjo këtu, mes dy prindërve. I lumtur për ekzistencën e këtyre



fotografive, Thaçi, në Hagë, kur isha për vizitë, disa herë u shpreh i kënaqur për ecjen e djalit deri atëherë dhe disa herë na ka porositur: Mos ma lini në shoqëri të keqe.

Endriti po ece perfekt me studime, shkallë mbi shkallë, afër tjetrës diplomë. Lumja, e ëma, i ka dhënë edukatë shembullore.

Kur ka në krah një axhë si Blerimin, ky djalë i urtë s'mund të jetë tjetër veçse model i shqiptarit kuptimplotë, modest e të suksesshëm.

Kur ishte 20-vjetori, më 2017, Hashim Thaçi si president i shteti e pati dekoruar Lëvizjen Studentore me dekoratë të lartë shtetërore.

Presidentja Osmani pritët në Paris nga homologu francez



PARIS, 4 TETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është pritët në Paris nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Me këtë rast, Osmani, e cila po merr pjesë në samitin e Frankofonisë, ka thënë se Kosova mbetet gjithnjë e përkushtuar për bashkëpunim dhe për fuqizim të pozitës ndërkombëtare. "Pritja nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron, Zonja e Parë,

Brigitte Macron dhe sekretarja e përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, Louise Mushikiwabo në Samitin e krerëve të shteteve të Frankofonisë. Kosova mbetet gjithnjë e përkushtuar për bashkëpunim dhe për fuqizim të pozitës së saj ndërkombëtare!", ka shkruar Osmani në "Facebook". Para kësaj pritjeje, presidentja Osmani ka takuar mërgatën tonë

në Francë. Në njoftimin e Presidencës është thënë se Osmani është shprehur që shteti i Kosovës mban vullën e mërgatës sonë të çmuar. "Në fjalën e saj, presidentja Osmani shprehu mirënjohjen për angazhimin e pakursyer të tyre ndaj Republikës sonë, duke thënë se shteti i Kosovës mban edhe vullën e mërgatës sonë të çmuar", ka njoftuar presidenca e Kosovës.

Komandanti i FSK-së dhe koloneli turk bisedojnë për vazhdimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 4 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletniant Bashkim Jashari, ka pritët për të mirë në takim komandantin e kontingjentit turk në Kosovë, koloneli Zafer Saglam.

Fillimisht, gjeneralletniant Jashari ka falënderuar

koloneli Saglam për mbështetjen e vazhdueshme që kontingjenti turk jep për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Më tutje, gjeneralletniant Jashari ka folur për zhvillimin e FSK-së si dhe për mundësitë bilaterale lidhur me trajnimet dhe aktivitete

të tjera të përbashkëta të cilat do të mund të realizohen në bashkëpunim dypalësh. Në takim, gjithashtu, është biseduar mbi bashkëpunimin e mirë me njësitë e FSK-së dhe për vazhdimin e mëtutjeshëm në fusha të zhvillimit të përbashkët.





Kurti: Për shkak të suksesit tonë, Beogradi është nervoz dhe agresiv

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një intervistë për "Bloomberg"-un, ka thënë se për shkak të suksesit të institucioneve të shtetit tonë, Serbia është më nervoze dhe agresive. Ai ka thënë se sa herë ndërmarrim veprime në veri, Serbia alarmohet. "Sa herë që ndërmarrim veprime ka zëra alarmues për përshkallëzimin e mundshëm, por ja ku jemi - Kosova është më mirë se kurrë më parë", ka thënë Kurti, duke mbrojtur veprimet e tij si të nevojshme për të rivendosur ligjin dhe rendin në veriun e ndarë prej kohësh

PRISHTINË, 4 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se kritikën ndërkombëtare për trajtimin nga qeveria e tij në raport me pakicën serbe në Kosovë kanë qenë të tepërta. Dhe ky koment, vlerëson një shkrim i "Bloomberg"-ut, ka të ngjarë t'i shqetësojë mbështetësit perëndimorë që kanë bërë thirrje për përmbytje. Siç shkruan mediumi në fjalë, lëvizjet e Prishtinës për t'i mbyllur institucionet e mbështetura nga Serbia dhe për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb kanë nxitur paralajmërimet nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian (BE) se veprimet mund të përbëjnë një kërcënim për paqen e brishtë në Ballkan. "Ata janë shumë të shqetësuar", citohet të ketë thënë Kurti për "Bloomberg" në një intervistë gjatë vizitës së tij në Varshavë. "Sa herë që ndërmarrim veprime, ka zëra alarmues për përshkallëzimin e mundshëm, por ja ku jemi - Kosova është më mirë se kurrë më parë", ka thënë Kurti. "Bloomberg"-u ka vënë në pah se në Kosovën veriore jeton pjesa më e madhe e komunitetit serb në

Kosovë. Veprimet, që përfshijnë mbylljen e degëve të bankave serbe në këtë pjesë, shkruan ky medium, pason një shkëmbim zjarri vitin e kaluar pranë një manastiri ortodoks në veri të Kosovës që la të vdekur një oficer policie të Kosovës dhe tre militantë serbë. Por, Kurti ka mbrojtur veprimet e tij si të nevojshme për ta rivendosur ligjin dhe rendin në veriun e ndarë prej kohësh. Ai, gjithashtu, ka këmbëngulur se hapat janë të nevojshëm drejt vendosjes së kontrollit mbi zonat me shumicë serbe dhe integritet të plotë të tyre të sistemit ligjor dhe financiare të Kosovës. "Përshtypja ime është se pikërisht për shkak se ne jemi të suksesshëm, Beogradi është më nervoz dhe rrjedhimisht më agresiv", ka thënë ai. "Bloomberg"-u ka përkujtuar se presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka akuzuar vazhdimisht Kurtin se po i bën presion komunitetit serb për t'u larguar nga Kosova. Ai ka kërkuar zbatimin e një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga BE-ja, sipas së cilës, komunitetit serb i lejohet njëfarë "autonomie". Veç këtyre, muajin e

kaluar Vuçiqi i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës të mbajë zgjedhje lokale në komunat veriore. Por ideja "nuk është e mundur të realizohet", ka thënë Kurti, duke shtuar se zgjedhjet do të mbahen vitin e ardhshëm. "Votimi në komunat veriore do të bëhet vetëm gjatë zgjedhjeve në vjeshtën e vitit të ardhshëm. Vuçiqi dështoi, dhe tani ai dëshiron që ne të paguajmë për dështimin e tij", ka thënë më tej Kurti, duke shtuar se koha kur presidenti serb ka ndikim në punët e brendshme të Kosovës "ka kaluar prej kohësh". Në fund të shkrimit, "Bloomberg"-u ka theksuar se, sipas një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga BE-ja në 2013, serbët ranë dakord të merrnin pjesë në qeveritë lokale dhe qendrore në Kosovë, por u larguan në vitin 2021 për shkak të pretendimeve për diskriminim dhe që atëherë kanë bojkotuar dy votime. Po sipas mediumit, arrestimet e serbëve vendas nga Policia e Kosovës kanë rritur gjithashtu tensionet, ndërsa disa mijëra paqeruajtës të udhëhequr nga NATO mbeten në zonë. Ndërkohë, ka thënë ky medium, për t'u kthyer në dialog, Kurti ka kërkuar nga Serbia dorëzimin e Milan Radoičiqit, i cili ka marrë përgjegjësinë për sulmin e armatosur të vitit të kaluar pranë manastirit. Ai i ka kërkuar gjithashtu BE-së të ushtrojë më shumë presion mbi Beogradin për të ndihmuar në "zbutjen e tensioneve" me një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve. "Është dashur të ndodhë dje. Unë besoj se është e mundur", ka thënë Kurti.

Kurti: Një triumf i Rusisë në Ukrainë do të kërcënonte paqen në Ballkan

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se rajoni i Ballkanit gëzon nivelin më të lartë të paqes, lirisë dhe demokracisë në 25 vjetët e fundit, por kjo mund të ndryshojë nëse Rusia triumfon në Ukrainë dhe inkurajon zgjerimin serb. Kurti në një intervistë për "Associated Press" ka thënë se është e rëndësishme që prishimi të qëndrojë i bashkuar në mbështetje të Ukrainës, shtet që po e mbron veten kundër pushtimit të nisur nga Rusia më 2022. Kurti ka argumentuar se një Rusi e fortë do të trimëronte Serbinë dhe jo vetëm Kosova, por edhe Bosnjë-Hercegovina, Mal i Zi "dhe ndoshta edhe Maqedonia e Veriut" do të rrezikoheshin nga, siç tha ai, ambiciet ekspansioniste serbe. Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të larta, teksa dialogu për normalizimin e raporteve - që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian - ka dështuar të shënojë përparim, veçmas që nga sulmi i armatosur ndaj Policisë së Kosovës në shtatorin e vitit 2023 në Banjskë të Zveçanit. Një grup i armatosur i serbëve sulmuan policinë, duke vrarë një rreshter të Kosovës. Në shkëmbimet e zjarrit që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë. "Këto 25 vjetët e këtij shekulli, ky çerekshkulli ka pasur nivelin më të lartë të paqes, lirisë dhe

demokracisë në Ballkan", ka thënë Kurti. I pyetur se çfarë do të nënkuptonte për Kosovën dhe Ballkanin nëse Rusia do të triumfonte në Ukrainë, Kurti ka thënë se "me Serbinë, që është hegjemoni rajonale dhe bashkëpunëtorë e Rusisë, këto 25 vjet paqe, liri dhe demokraci në Ballkan, të paprecedentë në historinë tonë, sërish janë në rrezik". "Presidenti despotik (rus, Vladimir) Putin do të inkurajohej për të vazhduar më tej me përpjekjet e tij për destabilizim, aq më tepër nëse ndihet i suksesshëm në Ukrainë. Unë vërtet nuk dua të besoj që, në teori, ai mund të fitojë, por vetëm ideja që ai mendon se mund ta fitojë luftën, është mjaftueshëm problematike", ka thënë ai. Edhe në të kaluarën Kurti, por edhe udhëheqës të tjerë shtetërorë, kanë paralajmëruar se Rusia mund ta përdorë Serbinë për t'i rritur tensionet në Kosovë dhe më gjerë në rajon. Serbia dhe Rusia kanë raporte të mira dhe Beogradi është ndër vendet e pakta në Evropë që nuk u është bashkuar sanksioneve të Bashkimit Evropian të vendosura ndaj Moskës për shkak të agresionit ndaj Ukrainës. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka deklaruar së fundi se Serbia nuk është "shërbëtorë as e Rusisë, as e Shteteve të Bashkuara".

Edhe opozita po premtion si pozita dikur



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA-BAJGORA

Shumë përralla për një grusht vota: LV-ja sa ishte në opozitë premtoi aq shumë saqë as Thesari amerikan nuk do të kishte mundësi t'i realizonte ato premtime. Baza e premtimeve ishte e natyrës sociale, si siguri për një mirëqenie materiale, rritja e pensioneve, pagave, ndihmave sociale, ulja e çmimeve të artikujve të domosdoshëm ushqimorë, mosrritja e çmimit të rrymës, shërbime shëndetësore cilësore dhe pa pagesë, ndërtimi i çerdheve dhe shkollave, rritja e vendeve të punës, azileve për të moshuar dhe përralla që flenë bukur në veshin e atyre që kanë nevojë. Jo që nuk pati asnjë realizim të këtyre premtimeve, por përkundrazi pati përkeqësim të gjendjes sociale; pensionet vendnumëruan sikur edhe pagat dhe ndihmat sociale. Nëse kemi parasysh ngritjen e çmimeve të thuaja gjithë artikujve të domosdoshëm për mbijetesë dhe shërbimeve, sidomos të rrymës del se pagat, pensionet dhe ndihmat sociale janë zhvleftësuar shumë. Qeveria për çdo gjë ka gënjer, brutalisht ka

shkelur premtimet gjatë fushatës duke ndikuar në varfërimin galopant të pjesës dërrmuese të qytetarëve të Kosovës. Shifrat për zhvillim ekonomik, vende të reja të punës, ngritje të mirëqenies janë rezultate të sajura nga ministra jokompetentë, hajdutë, mashtrues dhe të pafytyrë e që paraqet dhunim shtesë të qytetarëve. Një ministër mashtrues dhe renc, si puna e Hekuran Muratit, urrejtës patologjik i UÇK-së dhe mohues edhe më patologjik i të drejtave të luftëtarëve të UÇK-së, sa herë që kishte nevojë regjimi, sajonte shifra dhe bilance të porealizueshme edhe për Luksemburgun e lëre më për Kosovën, ushtarët e së cilës nuk kanë mjaftueshëm as fasule për ta mbushur barkun. Po kjo Rozeta Hajdari, po të mos ishin në pyetje rezervat shtetërore që me injorancën dhe dashakeqësinë e saj i shndërroi në rezerva private, për çka do të mbahej mend?! Për punën e saj, sigurisht jo. Arben Vitia, një mumie politike mashtruese, me kollare, i ricikluar nga Kurti sipas bioritmit politik të kryeministrit nuk ka bërë asgjë përveç se ka rritur shkallën e mortalitetit dhe tenderët njëburimorë. Mashtrues që ia kalon edhe Ostap Benderit, doajen dhe legendë e mashtruesve botërorë. Për çka do të kujtohet analfabetja magjistre e arsimit, Arbërie Nagavci përveç se e ka përligjur analfabetizimin në të gjitha nivelet. I ka dy suksese personale. I pari se është bërë

ministre e që konsiderohet se është meritë e Albin Kurtit dhe i dyti se thuaja i ka mësuar të gjitha shkronjat e alfabetit, e që është sukses personal ku roli i kryeministrit Kurti më shumë është inkurajues se vendosës. Njëri ndër dhunuesit brutal të buxhetit të shtetit është HAJNnullah Çeku që ka ndarë para me thes për vete, partinë dhe miq, narkomanë dhe piromanë, etj. Rastet i ka dërguar te Antikorruptioni ku preni dhe qep rrobaqepësi që punon vetëm sipas masave të Albin Kurtit. Ose një ministre për Punë të Jashtme e cila për një mandat të plotë nuk e ka asnjë njohje, asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare e që veten, pa asnjë turp dhe brejtje të ndërgjegjes e quan ministre të suksesshme. Në vende normale ajo do të duhej të ishte në një institucion tjetër ku Kosova nuk do të pësonte dhe bëhej hor kurse ajo do të përfitonte personalisht. Faton Peci është atraktiv kur e luan trimin. Nga aspekti psikologjik e nevojës së kompensimit të asaj që nuk e keni, në rastin e Fatonit - trimërisë, si armë përdorni postin dhe pushtetin. Ashtu ka vepruar edhe Shemsi faqeziu. Fatoni krekosej se ia ftohi Ramushit duke e përzënë nga objekti ku ishte selia e AAK-së me shpresë se Ramushi do të kundërshtonte dhe do të rritej nami, emri, jo edhe mbiemri dhe vepra e Faton Peci. Ramushi doli në një vend më të mirë, u tregua shumë i matur dhe praktik duke e lënë Fatonin cipricullak në trimërinë e tij. Për

Xhelë Pandurin, Albulenën, Hysen Aliun, dhe ministra tjerë, në ndonjë shkrim tjetër. Premtimet politike të Albin Kurtit dhe LV-së ishin se do t'i zhbëjnë të gjitha marrëveshjet me Serbinë, nuk do të bisedojnë pa kërkimfalje dhe zbardhje të fatit të personave të zhdukur dhe se do ta bëjnë padinë për gjenocid kundër Serbisë. Këtu është mashtrimi dhe dështimi më i madh i Albin Kurtit dhe LV-së. Jo që nuk e zhbënë asnjë marrëveshje me Serbinë, por e pranoi marrëveshjen e Brukselit me aneksin e Ohrit të cilën nuk do ta nënshkruanin as Rrahman Morina e Ali Shukriu. Po bisedohet me Serbinë pa asnjë kërkimfalje. Për fatin e të zhdukurve më shumë po angazhohet Bajram Qerkini se i tërë kabineti qeveritar, Kuvendi i Kosovës apo presidenca e Vojsa Osmanit. Sa i përket padisë për gjenocid, sigurisht ka menduar për Ruandën dhe Srebrenicën. Jo që nuk ka bërë padi për gjenocid me të cilën do të sanksionohet klasa politike, policore dhe ushtarake e Serbisë, por ka arritur efektin e kundërt, mbase të dëshiruar për veten e tij duke krijuar rrethana, kushte dhe mundësi për dënimin e udhëheqësve politikë dhe ushtarakë shqiptarë që e bënë dhe e fituan luftën çlirimtare, e shpallën pavarësinë dhe e bënë shtetin.

Po opozita: Opozita, në vend se të mbledhë mend nga mashtrimet dhe dështimet e Albin Kurtit e që është edhe LV-ja vet, po shkon gjurmëve të

atyre mashtrimeve duke premtuar çdo gjë që nuk varet nga ajo dhe duke lënë anash çdo gjë që varet nga opozita. Opozita, edhe nëse fiton 100 për qind të votave nuk ka asnjë gjasë ta zhbëjë apo ndryshojë marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit, këtë e kanë të qartë edhe Halili me Dimalin, personalitetet më inteligjente që kam njohur përmes deklaratave publike. Për fat të keq nuk kam pasur kënaqësinë t'i takojë, as personalisht, as publikisht e as ilegalisht. Opozita ka mundësi shumë të kufizuara të bëjë, si me shkop magjik, ndërhyrje të mëdha për përmirësim të kualitetit të jetës. Opozita e ka të qartë që përmbajtjen e marrëveshjes që e ka pranuar Albini, ta mbështjell me një pëlhurë opozitare që lë përshtypjen se është ndryshe. Ose siç do të thoshte Rashiçi, Sejdo Bajramoviçi i serbëve të Slobës: "isto govne, drugo pakovanje - m.i i njëjtë, paketimi ndryshe...". Pa asnjë dyshim se opozita do të rritet, jo se ka punuar shumë dhe mirë, por se Albini nuk ka punuar, as mirë e as drejtë. Ka mashtruar thuaja për çdo gjë. Albini u rrit shumë shkaku i dështimit të pozitës së atëhershme, propagandës gebelsiane të mihali-qëve dhe urrejtjes së shfrenuar ndaj udhëheqësve të luftës dhe të shtetit. Këtu përfundon mashtrimi i vjetër i pozitës aktuale dhe nëse nuk mbledhin mend, me gjasë këtu fillon mashtrimi i pozitës aktuale për të ardhur në pushtet!

Veriu dhe Serbia nuk janë problemi i vetëm i Kosovës, e as maja e problemeve që kemi si shoqëri



Shkruan: Ismet KRYEZIU

Për vite me radhë veriu është përdorur si mbulesë për ta shmangur adresimin e sfidave reale që pengojnë përparimin e shoqërisë sonë, si reformat e nevojshme në zhvillimin

ekonomik, qeverisjen e mirë dhe luftën kundër korrupsionit. Vazhdojmë të përballemi me mungesën e etikës dhe integritetit në qeverisje, me mungesë të reformave të domosdoshme në arsim dhe shëndetësi, me zyrtarë të profiëve të larta të akuzuar për keqpërdorim të pozitave publike, me gjyqësor joefikas në ndëshkimin e korrupsionit, me tenderë njëburimor e lidhje të kompanive me profile të larta politike. Nepotizimi dhe politizimi i bordeve me militantë dhe aktivistë partiakë vazhdojnë të jenë probleme.

Ende sot, më shumë se meritokracia si vlerë, librezja partiake dhe shërbimi ndaj partisë janë standardi i vetëm për punësim dhe sukses në biznes. Kjo mungesë kompetence dhe përkushtimi ka prekur sektorët kyçë si ekonomia, arsimit dhe shëndetësia, duke penguar përparimin e shoqërisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Problemet janë të shumta dhe mund ta zgjerojmë listën e tyre, duke i dhënë dimensione më specifike që cenojnë barazinë gjinore, të rinjtë, migrimin ekonomik,

pensionistët dhe shumë kategori të tjera qytetarësh të marginalizuar. Prandaj, në prag të zgjedhjeve parlamentare, kur partitë politike, liderët e tyre dhe kandidatët potencialë kanë filluar të prezantojnë programe, ide dhe premtime, qytetarët kanë një mundësi unike për të kërkuar dhe për të zgjedhur përfaqësues që angazhohen vërtet për përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë. Kjo është koha kur ne, si qytetarë, duhet të angazhohemi në mënyrë aktive, të lexojmë dhe vlerësojmë programet e partive

dhe kandidatëve, të marrim pjesë në debate publike dhe të kërkojmë përfaqësues me integritet dhe kompetencë për përgjegjësitë publike. Procesi zgjedhor është më shumë se një ditë votimi - kjo periudhë ka filluar, dhe është një mundësi ku secili prej nesh duhet të jetë votues i informuar, të ndikojmë për të shtyrë përpara ide dhe për të zgjedhur programe, parti dhe deputetë të përkushtuar ndaj reformave në fusha kyçe si ekonomia, arsimit, shëndetësia dhe lufta kundër korrupsionit. Pjesëmarrja aktive në këtë periudhë është vendimtare.

Lajçaku: Përcaktimi i prioriteteve të BE-së për Ballkanin, shmang sfidat

PODGORICË, 4 TETOR - Emisari special i Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka marrë pjesë në organizimin për politikë dhe siguri në Evropën Juglindore, forumin 2BS. Në platformën "X",

Lajçaku ka nënvizuar rëndësinë e prioriteteve të BE-së në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor. "Në një diskutim mbi prioritetet dhe sfidat për Ballkanin Perëndimor, theksova rëndësinë e përcaktimit të

qartë të prioriteteve të Bashkimit Evropian për t'i shmangur sfidat e ardhshme në rajon", ka shkruar ai. Forumi 2BS bashkon çdo vit figurat kyçe të politikës regjionale e globale në Mal të Zi.



Opozita, kritika për mungesë dhe çmime të larta të barnave 'deri në 400 për qind'

PRISHTINË, 4 TETOR - Partitë opozitare kanë pasur kritika në adresë të ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia. Sipas tyre, pavarësisht prej rritjes së buxhetit për barna esenciale, ato mungojnë në spitale dhe blihen deri në 400 për qind më shumë.

Krahas çmimit të barnave, kritikantët e opozitës ishin edhe për mungesën e investimeve kapitale dhe ikja e profesionistëve shëndetësorë.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka kritikuar qeverinë Kurti dhe ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, duke thënë se është rritur buxheti për barna, por ato mungojnë në spitale. Sipas tij, barnat janë duke u blerë më shtrenjtë deri në 400 për qind.

"Ligji për Çmimet e Barnave ka ndikim nga mafia farmaceutike. E kemi përkrahur anulimin e listës, por sot ende ligji nuk është në fuqi. Është rritur buxheti për barna, por pse ka mungesë më të madhe të barnave sepse blerja e tyre është 400 për qind më e shtrenjtë? Këto janë evidente", ka deklaruar Zemaj. Ai ka thënë se nuk mund të flitet për reforma sepse nuk ka reformë në legjislacionin e shëndetësisë. "Ju mund të thoni që ka ligj për shëndetësi, por nuk ka ligj të ri për

shëndetësi. Nuk e kemi në Kuvend. Nuk ka as ligje të tjera, as ai për sigurime shëndetësore", ka deklaruar Zemaj.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se janë shumë afër zbatimit të Ligjit për Çmimet e Barnave. "Është rrugës për ta nisur zbatimin Ligji për Çmimet e Barnave. Ka pasur sfida, por edhe vëmendjen tonë në çdo hap. Në legjislacion dhe infrastrukturë, furnizim me barna dhe resurse njerëzore, janë disa masa që janë ndërmarrë këtë mandat. Gjithashtu, janë proceduar katër ligje dhe 20 aktenë ligjore. Ligji për Produktet Mjekësore, Ligji për Fertilizim, Ligji për Detyrime Shëndetësore dhe Ligji për Shëndetësi. Janë, gjithashtu, edhe 20 akte nënligjore që janë shumë të rëndësishme në pjesën e reformave", ka thënë Vitia. Kurse për ikjen e profesionistëve shëndetësorë, ministri Vitia ka thënë se ata janë duke u kthyer në Kosovë. "Janë kthyer në Kosovë, janë kthyer për të kontribuar. Ata që kanë ikur më herët po vazhdojnë të kthehen. Keni dy raste në Pejë ku janë kthyer dy mjekë", ka thënë Vitia.

Përplasje ndërmjet Vitisë dhe Zemajt ishte edhe përcaktimi i



çmimit tavan. Sipas Zemajt, ish-këshilltarë të ministrit Vitia aktualisht punojnë në kompanitë farmaceutike, derisa ka thënë se sa ishin në ministri lobonin për favor të kompanive farmaceutike.

Haxhiu i PDK-së: Renovimet në QKUK me kontrata kriminale

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, në mbledhjen e Komisionit për Shëndetësi, ka lëshuar një video ku dëgjohej kryeministri Albin Kurti

dhe ministri Arben Vitia duke premtuar sigurimet shëndetësore. Ai ka pasur kritika për vlerat e renovimeve të klinikave të QKUK-së, duke i quajtur "kontrata kriminale". "Kemi të bëjmë me zhvatje të buxhetit dhe konflikt të interesit, kompani që kanë përfitur shumë më shtrenjtë nga çmimi real i tregut. Heqja e tepsonit në Gjinekologji ka kushtuar 33 euro, ndërsa heqja e saj në çmimin e tregut është 1 euro. Heqja e dyerve ka kushtuar 22 euro, pra një heqje e derës 22 euro, në çmimin e tregut është 10 euro. Këto

kontrata janë kriminale, madje edhe punët që janë bërë kanë mbetur në hije nga këto veprime", ka thënë Haxhiu, duke adresuar kritika edhe për listën e gjatë të pritjes për rezonancë magnetike. "Një pyetje zotëri ministër. A e dini kush ka pasur guxim të pranojë infermierë me shkollë të mesme pa pasur fare shkollën e mesme të mjekësisë? Është zonja Elvira, e cila është punësuar në Spitalin e Mitrovicës si infermiere pa shkollë të mesme të mjekësisë. Është motra e një asamblisti të IV-së në Vushtrri", ka thënë Haxhiu.

Haradinaj: Me AAK-në në qeveri, Istogu do të shndërrohet në pikënisjen e autostradës së Dukagjinit



ISTOG, 4 TETOR - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në Kuvendin e degës së Aleancës në Istog. Me këtë rast, Ukë Blakaj është zgjedhur kryetar i kësaj dege. Haradinaj ka thënë se Blakaj do të jetë edhe kandidat i AAK-së për kryetar të komunës së Istogut në zgjedhjet lokale. "Në Kuvendin e degës së Aleancës në Istog dhe në hapjen e selisë së re të degës, një qytet me të cilin kam lidhje të thella emocionale që nga lufta për liri. Rezultat i këtij kuvendi, është zgjedhja e kryetarit të ri të degës së Istogut, z. Ukë Blakaj, një afarist i

suksesshëm nga diaspora. Këtë detyrë deri sot me shumë sukses e kreu Bekë Berisha, aktualisht deputet, i cili angazhimin e tij për vendin do ta vazhdojë nga pozicione të tjera partiake dhe parlamentare. Angazhimi ynë për të sjellë përvojë dhe energji të reja në radhët tona është i vazhdueshëm. Ukë Blakaj gjithashtu është nominuar si kandidat për kryetar të Komunës së Istogut dhe ka marrë miratimin për të garuar edhe për ulëse në Kuvendin e Kosovës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ndër të tjera, ai ka përmendur se

me AAK-në në qeverinë qendrore prioritet do të jetë autostrada e Dukagjinit. "Pas 9 shkurtit, me Aleancën në qeveri, Istogu do të shndërrohet në pikënisjen e Autostradës së Dukagjinit, një projekt madhështor që do ta lidhë me Prizrenin. Kjo do të hapë mundësi të reja zhvillimi për të gjithë rajonin. Së bashku, jemi të vendosur ta shndërrojmë Istogun dhe mbarë Kosovën në një destinacion tërheqës për investime, me ekonomi të zhvilluar dhe të integruar plotësisht në NATO e BE", ka shkruar Haradinaj.

IKShPK-ja: Uji i liqenit të Badocit të mos përdoret për pije

PRISHTINË, 4 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka rekomanduar që uji nga Liqeni i Badocit të mos përdoret për pije, por vetëm për pastrim. Kjo pasi, sërish në analizimin e mostrave të marra nga ky liqen, janë vërejtur nivele të ngritura të manganit.

Edhe vitin e kaluar IKShPK-ja kishte rekomanduar mospërdorimin për pije të ujit të Badocit për shkak të ngritjes së vlerave të manganit.

Ky institut ka theksuar se paraqitja "e fenomenit" të manganit në Badoc është dukuri

e vazhdueshme, që ndodh "kryesisht në kohën e ndërrimit të stinëve".

"Të dhënat e analizave të bërë dhe krahasimi i tyre me të dhënat e ditëve paraprake, si dhe përvoja nga situata e vitit 2023, na tregojnë se gjatë kohëzgjatjes së këtij fenomeni, vlerat e manganit kanë tendencë të rritjes së vazhdueshme ditë pas dite, andaj IKShPK-ja për këtë periudhë rekomandon që uji të mos konsumohet për pije dhe të përdoret si ujë teknik për higjienë personale dhe ambientale", ka njoftuar IKShPK-ja.



IKShPK-ja ka publikuar një hartë të zonave që furnizohen me ujë të pijshëm nga liqeni i Badocit.

Ndër to janë disa lagje të Prishtinës, sikurse Matiqani, Aktashi, Bregu i Djellit, e lagja e

spitalit, por edhe Graçanica.

Instituti ka theksuar se, pavarësisht se mangani konsiderohet lëndë ushqyese thelbësore dhe kontribuon në shumë funksione trupore, vlerat e larta të tij në ujë të pijshëm mund të kenë ndikim të dëmshëm në shëndet, "e posaçërisht te fëmijët deri në 5 vjeç".

IKShPK-ja, po ashtu, i ka kërkuar ujësjellësit rajonal "Prishtina" që ta kontrollojë procesin e dezinfektimit të ujit, ta përcjellë gjendjen e ndotjes organik dhe ta pastrojë rrjetin e shpërndarjes, pra të gypave.

Prokuroria Speciale: Ridvan Muharremi u intervistua në cilësinë e të pandehurit

PRISHTINË, 4 TETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka dalë me njoftim pas intervistimit të Ridvan Muharremit. Nga kjo prokurori kanë bërë me dije se "Ridi" është intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për një rast penal. Bëhet fjalë për skandalin me rezervat shtetërore. "Pas interesimit për të marrë informacion nga një numër i madh i gazetareve, Prokuroria Speciale informon se sot, Ridvan Muharremi, është paraqitur në Prokurorinë Speciale me ftesë të kësaj prokurorie. I njëjti është duke u intervistuar në cilësinë e të pandehurit për një çështje penale, të cilën kjo prokurori e ka në hetim", ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës.

Avokati i Muharremit, Mahmut Halimi, ka folur pas intervistimit të klientit të tij për rezervën shtetërore. Ai ka thënë se Muharremi vetëm ka ndërmjetësuar verbalisht, pasi punët i ka kryer dikush tjetër.

"Ky ka ndërmjetësuar verbalisht dhe të tjerët i kanë kryer punët, e kontaktet i ka vë tjetërkush, absolut", ka deklaruar Halimi për "Betimi për Drejtësi".

Halimi ka thënë se rasti ka të bëjë me blerjen e vajit dhe sheqerit, por jo edhe të grurit. Sipas tij, prokuroria i ka të gjitha provat lidhur me mallin që kishte mbërritur në portin e Durrësit dhe për heqjen e bllobove nga porositë që kishin mbërritur nga Turqia. Ai ka deklaruar se klienti i tij s'ka të bëjë asgjë me këtë rast pasi zyrtarët e ministrisë kanë qenë përgjegjës.

Muharremi njihet si pronar i restorantit "Bukë e Zemër" dhe,

gjithashtu, i afërt me kryeministrin Kurti. Madje lokalit e Ridit, Kurti e kishte vizituar edhe me emisar Miroslav Lajçak.

"Nacionale" kishte raportuar e para për një sasi të madhe të grurit, vajit e sheqerit, që ishte paguar për rezervë shtetërore, por mall i cili nuk kishte ardhur asnjëherë.

Pavarësisht se rezerva kishte qenë temë e klasifikuar si sekret, me të ishte marrë edhe pronari i "Bukë e Zemër", Ridvan Muharremi.

Për këtë temë muaj më parë ishte intervistuar edhe ministrja e Tregtisë, Rozeta Hajdari. "Rozeta Hajdari, ministre në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është paraqitur në Prokurorinë Speciale për t'u intervistuar në cilësinë e të pandehurës, nën dyshimin se ka kryer veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar', nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me rezervat shtetërore. Mirëpo e njëjta sot nuk është deklaruar, dhe siç e parasheh Kodi i Procedurës Penale ka shfrytëzuar të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje", ishte thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Rozeta Hajdari, pas përfundimit të deklaratës në Prokurorinë Speciale të Kosovës, kishte thënë se nuk është intervistuar në cilësinë e të dyshuarës për keqpërdorim e rezervave shtetërore, por për legjislacionin në fuqi për rezervat shtetërore.



"Kjo kërkon qartësi në legjislacionin në fuqi që është Ligji për Rezervën Shtetërore, Ligji për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar dhe ligjet e tjera, prandaj derisa t'i marrim qartësitë përkatëse, ne do të bëjmë kërkesën dhe të vijmë t'ju japim përgjigjet që kanë nevojë t'i marrin", ishte shprehur ajo. Pas raportimit të "Nacionales" ishin arrestuar tre të dyshuar: Ridvan Muharremi, Irfan Lipovica dhe Hafiz Gara. Më pas ata ishin liruar nga paraburgimi me vendim të Gjykatës së Apelit. "Nacionale" ka raportuar se hetuesit të cilët e kanë hetuar aferën e rezervave janë drejt largimit nga Njësia e Veçantë Hetimore e Policisë së Kosovës. Gjithashtu, muaj më parë, ministrja Rozeta Hajdari, kishte tentuar të iniciojë hetim

ndaj hetuesve që e zbardhën këtë aferë, me arsyetimin se nuk kanë pasur certifikatë të sigurisë. I njëjti tentim ishte rrëzuar nga Prokuroria Speciale.

Avokati i Ridvan Muharremit, e kishte akuzuar ministren Rozeta Hajdari, duke thënë se ajo e kishte angazhuar klientin e tij në rastin e rezervave. "E ka angazhuar Ministria. Drejtpërdrejt ministrja Hajdari. E ka njohur si person afarist, që ka traditë të gjatë, ka rreth të gjerë të miqve të vetë. Janë mysafirë të cilët shkojnë në restorantin e tij. Ka një restorant modest ku shërbehen ushqime tradicionale. Sjellje e shkëlqyer, pritje, nuk ka shkuar vetëm Kurti e ministrat, por plot ambasadorë", kishte deklaruar avokati Halimi. Në konferencën për medie, ministrja e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ishte pyetur për afaristin Ridvan Muharremi, i cili është pronar i restorantit "Bukë e Zemër" dhe i njëjti është arrestuar sot nga Policia e Kosovës.

Hajdari ka deklaruar se Muharremi nuk është në ndonjë kontraktim të kontratave për rezerva shtetërore. Ajo tutje kishte thënë se vetë i ka nënshkruar kontratat për rezerva shtetërore që janë sekret. "Unë s'kam asnjë informacion që personi në fjalë është në ndonjë kontraktim të kontratave për rezerva shtetërore. Unë vetë si ministre i kam nënshkruar kontratat për rezervat shtetërore që janë si sekret. Përndryshe ministria ka nënshkruar shumë operatorë, por jo vetëm një", kishte thënë Hajdari.

Protesta e mësimdhënësve të Vitisë, Jasharaj: Java e ardhshme mund t'i gjejë në grevë nëse nuk u dalin pagat

PRISHTINË, 4 TETOR - Për shkak të mosprocedimit të pagave për punëtorët e arsimit në Viti, kryetarët dhe kryesitë e shoqatave sindikale nga shkollat e kësaj komune kanë protestuar të premtën para Qeverisë së Kosovës.

"Edhe Vitia është n'Kosovë", "Duam pagat tona", kanë qenë thirrjet e mbishkrimet në pankartat e protestuesve, të cilët kanë kërkuar që pagat të ekzekutohen ose më së largu të hënën, në të kundërtën kjo komunë do të fillojë me veprime sindikale nga java e ardhshme.

Kryetari nga Sindikata e Bashkuar për ARSim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se mësimdhënësit janë të pafajshëm në këtë drejtim, ndërsa i ka bërë thirrje qeverisë të fillojë ekzekutimin e pagave.

Jasharaj ka theksuar se nga ajo që ka parë në takim nga kryetarët e shoqatave, ata janë shumë të revoltuar dhe java e ardhshme mund ta gjejë Vitinë në grevë.

Ndërsa Kemail Bislimi, kryetar i

nivelit komunal të sindikatës së arsimit në Viti, ka thënë se kanë protestuar edhe në komunën e Vitisë mirëpo, sipas tyre, faji qëndron te qeveria. Ai ka thënë vetëm mësimi fillor dhe të mesëm nuk i janë ndarë mjetet, duke shtuar se aty janë 775 punëtorë.

Në anën tjetër, pjesëmarrës në këtë protestë ishte edhe kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykoll, i cili i ka bërë thirrje qeverisë ta bëjë ekzekutimin e pagave të mësimdhënësve të komunës së Vitisë.

Kurse nga Ministria e Financave ka njoftuar se kjo komunë nuk ka siguruar buxhetin e nevojshëm, dhe se pagat janë ekzekutuar vetëm për një pjesë të punonjësve të komunës. Në njoftim është thënë se përkundër që buxheti për paga ndahet asisoj që ta mbulojë shpenzimin për tërë vitin, si pasojë e rasteve përmbarrimore, disa komuna kanë filluar të kenë mungesë buxheti në kategorinë e pagave qysh tani.



Nëse ka rritje ekonomike, pse nuk po e ndiejnë qytetarët?

PRISHTINË, 4 TETOR - Institucionet e Kosovës, por edhe mekanizmat financiarë ndërkombëtarë, kanë parashikuar se Kosova do të ketë rritje ekonomike rreth 4 për qind më 2024.

Një rritje ekonomike në këtë nivel do të duhej të ofronte lehtësi për ngritjen e standardit jetësor. Por, megjithatë, ajo nuk pritet të ketë ndikim të madh në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, vlerësojnë njohësit e fushës së ekonomisë.

Pse kjo rritje është e pamjaftueshme?, ka pyetur profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj.

“Duke pasur parasysh bazën e kësaj rritjeje, që e kemi relativisht të ulët, nuk është e mjaftueshme për rritje ambicioze, qoftë të të ardhurave, qoftë të treguesve të tjerë makroekonomikë, në kuptim të rritjeve të mëdha buxhetore apo edhe rritjes së mirëqenies, pagave apo të kategorive qoftë sociale, qoftë ekonomike”, ka shpjeguar Ramosaj për “REL”-in.

Ngjashëm është shprehur edhe kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka ka thënë se, pavarësisht se një rritje prej 4-përqindësh do të duhej të ndikonte në mënyrë të lehtë edhe në ngritjen e standardit jetësor, problem mbetet niveli i inflacionit. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, norma e inflacionit më 2022 ishte 11.6 për qind. Ajo u ul në 4.9 më 2023, dhe ra edhe më shumë sivjet. Në gusht inflacioni ishte në nivelin prej 1.4-

përqindësh, nën mesataren e Bashkimit Evropian dhe të Eurozonës. Ministri i Financave i Kosovës, Hekuran Murati, ka thënë në fund të shtatorit se rritja ekonomike dhe rënia e inflacionit janë tregues se “bizneset dhe ekonomia e vendit po kthehen në trajektoren e rritjes më të shpejtë, aty ku edhe nisëm pas pandemisë”.

Nevoja për rritje dyshifrore

Mirëpo, rritja ekonomike, sipas Zekës dhe Ramosajt, është e bazuar kryesisht në konsum. Niveli i lartë i konsumit, vlerësojnë ekspertët, pashmangshëm lidhet me nivelin e lartë të remitencave. Ramosaj ka thënë se paratë nga diaspora investohen kryesisht në patundshmëri, pra në blerjen e tokave dhe të banesave dhe, sipas tij, këto investime nuk kapitalizohen në Kosovë. Kjo nënkupton se paratë e freskëta në Kosovë “nuk shkojnë në ata sektorë që mund të rrisin të ardhurat, si industria e përpunimit apo sektorë të tjerë të zhvillimit”.

Ekspertët ka vlerësuar se në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve, rritja ekonomike në Kosovë duhet të jetë dyshifrore, që vendi të arrijë nivelin e shteteve të Bashkimit Evropian, ku dhe synon të anëtarësohet. “Edhe në raportet e institucioneve financiare ndërkombëtare, për shembull të Korporatës Financiare Ndërkombëtare, thuhet që me



normën aktuale të rritjes ekonomike që Kosova e ka vitet e fundit, do të thotë një 4 për qindësh apo edhe 5 për qindësh, Kosovës do t'i duhen diku edhe tri dekada që, në aspektin e kushteve jetësore ose standardit jetësor, të zërë hapin me shtetet me ekonominë më të dobët në BE”, ka thënë Zeka.

Ndryshimi i kahut të investimeve

Si ndryshohet gjendja? Sipas Zekës, nevojitet promovim i ofertës së vendit për tërheqjen e investimeve para investitorëve të jashtëm, si dhe rritje e jashtëzakonshme e

vëllimit të investimeve të huaja. “Sektorët aktualë që tërheqin investime të huaja direkte nuk ndihmojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik”, ka thënë ai, duke përmendur patundshmëritë dhe ndërtime të reja.

Zeka ka sugjeruar se këto investime duhet të shkojnë në sektorë që krijojnë vende pune dhe krijojnë produkte me vlerë të shtuar, që do të kishin edhe ndikim në ndryshimin e deficitit tregtar përmes rritjes së eksporteve dhe zvogëlimit të importeve. Raportet tregojnë se investimet e huaja direkte në Kosovë më 2023 ishin në vlerë prej

816 milionë eurosh, apo 84 milionë më shumë sesa në vitin paraprak.

Kosova prej vitesh përballet me nivel të lartë të importit krahasuar me atë të eksportit.

Ramosaj ka thënë se bilanci tregtar në raport mes eksportit dhe importit duhet të ndryshohet, pasi pjesa e madhe e mjeteve të kosovarëve, respektivisht të Kosovës, dalin nga Kosova për shkak të importit të nivelit të lartë. Më 2023 vlera e mallrave të importuara arriti shifrën prej 5.9 miliardë eurosh, shifër shumë e lartë krahasuar me eksportin që arriti në vlerë prej 863 milionë eurosh.

Përmbaruesi privat bllokoi përsëri llogaritë e Telekomit të Kosovës

PRISHTINË, 4 TETOR - Telekomit i Kosovës ka njoftuar se sërish i janë bllokuar llogaritë nga përmbaruesi privat lidhur me rastin e “Z-Mobile”. “Pas refuzimit të prapësimit të urdhrin përmbarimor që lidhet me arbitrazhin në rastin ‘Dardafon 2’ (Z-Mobile) nga ana e Gjykatës Komerciale, dje, më 03.10.2024, Përmbaruesi Privat me të pranuar këtë Aktvendim vetëm brenda një ore, i ka bllokuar të gjitha llogaritë bankare të Telekomit të Kosovës. Ky bllokim i llogarive bankare të Telekomit të Kosovës nga ana e Përmbaruesit Privat është i bazuar në vendime tërësisht të padrejta, andaj Telekomit i Kosovës do të vazhdojë të kundërshtojë këto vendime që janë pasojë e një kohe dhe një keq menaxhimi të ndikuar skajshëm nga politika e asaj kohe edhe nga interesa të fuqishme private. Siç është i informuar publiku tashmë, ky rast është pasojë e dytë më e madhe e një kontrate tejet të dëmshme të vitit 2009, përmes së cilës Telekomit i Kosovës, deri tani, përveçse është dëmtuar financiarisht me mbi 100 milionë euro, është detyruar



padrejtësisht të paguajë edhe mbi 60 milionë euro të tjera përmes proceseve gjyqësore që ishin kurdisur përmes kësaj kontrate. Me këtë bllokim të llogarive

Përmbaruesi privat synon të tërheqë nga llogaritë e Telekomit të Kosovës, dhe për interes të Z-Mobile, edhe rreth 12 milionë euro borxh kryesor”, ka njoftuar

Telekomit i Kosovës. Më tutje, Telekomit i Kosovës ka njoftuar se do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet për zhblokimin e shirrlojarive. “Edhe pse

Telekomit i Kosovës ka bërë kallëzim penal në organet përkatëse të rendit si dhe publikisht në vazhdimësi e ka denoncuar këtë kontratë lidhur me pasojat e shumta negative që e njëjta ka prodhuar dhe vazhdon të prodhojë, për kompaninë nga skemat e organizuara për përfitime të grupeve të caktuara të interesit, fatkeqësisht deri më sot askush nga zyrtarët dhe personat e përfshirë në këtë skemë kriminale nuk ka dhënë llogari para gjykatës. Menaxhmenti i Telekomit të Kosovës, që nga sot, bashkë me Bordin e Drejtorëve, do të analizojnë dhe ndërmarr të gjithë hapat e mundshëm me qëllim të zhblokimit sa më të shpejtë të llogarive të bllokuara bankare si dhe do të kujdeset të vazhdojë sigurt procesin e modernizimit të shërbimeve, si dhe të gjitha proceset e tjera të punës dhe biznesit, të cilat po e rikthejnë kompaninë tonë, ngadalë por sigurt, në vendin që i takon si ofruesi i parë i shërbimeve të telekomunikimit në vendin tonë”, ka njoftuar Telekomit i Kosovës.

Epoka e artë e mafies: Kush janë 5 Familjet?



Skenë nga filmi *Goodfellas*

Nëse doni të mësoni për krimin e organizuar në Nju Jork, duhet të dini për Pesë Familjet. Këto organizata të fuqishme italo-amerikane ishin në qendër të krimit të organizuar në qytet për disa dekada, duke përfshirë periudhën e njohur si Epoka e Artë e Mafias.

Në këtë artikull, shikojmë se si familjet morën fuqi dhe si autoritetet i frenuan aktivitetet e tyre.

Origjina e pesë familjeve

Mafia në Nju Jork i ka rrënjët te mafia siciliane (Cosa Nostra) dhe vala e migrimit italian në SHBA në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Megjithatë, historia e Pesë Familjeve filloi me të vërtetë në fillim të viteve 1930, pas kulmit të përgjakshëm të Luftës Castellammase.

Lufta përfundoi kur kreu i familjes së krimit të organizuar Castellammarese, Salvatore Maranzano, urdhëroi vrasjen e Joe Masserias, kreu të familjes rivale Masseria. Maranzano më pas riorganizoi mafian në qytet, duke u vetëshpallur "bos i të gjithë bosëve" mbi Pesë Familjet origjinale: Luciano, Gagliano, Mangano, Maranzano dhe

Profaci.

Kur Maranzano u vra në një atentat të urdhëruar nga ushtari i tij Charles 'Lucky' Luciano, kjo çoi në krijimin e Komisionit, në thelb një organ qeverisës për mafian.

Pesë Familjet më vonë u bënë të njohura si Bonanno, Colombo, Gambino, Genovese dhe Lucchese. Çdo organizatë kishte një bos, një hierarki dhe territore të përcaktuara.

Bonanno

Familja Bonanno operon në zonat e Manhattan, Bronx, Brooklyn, Queens, Staten Island dhe Long Island, si dhe territore jashtë Nju Jorkut. E njohur më parë si familja Maranzano, në vitin 1976, ajo u infiltrua nga Joseph Pistone, një agjent i FBI-së i cili punonte me pseudonimin "Donnie Brasco".

Kolombo

Familja Colombo vepron kryesisht në zonat e Brooklyn, Queens dhe Long Island. Fillimisht ishte e njohur si familja Profaci, e cila e nisi aktivitetin si një bandë vjedhësish gjatë Prohibicionizmit. Më e reja nga

familjet, ajo u riorganizua si familja Colombo në vitet 1960. Ajo konsiderohet nga forcat e rendit si më e dobëta e Pesë Familjeve.

Gambino

Familja Gambino operon në territore në të gjithë Brooklyn, Queens, Manhattan, Staten Island dhe Long Island. E njohur fillimisht si familja Mangano, në fund të viteve 1950, nën drejtimin e Carlo Gambinos, ajo u bë një nga organizatat më të fuqishme të krimit. Ndoshta shefi i saj më i famshëm ndër vite ishte John Gotti. I quajtur 'Teflon Don' për shkak të aftësive të tij për të shmangur dënimin për krimet e tij, Gotti përfundimisht u dënua me burgim të përjetshëm në 1992.

Genovese

Familja Genovese operon në pjesë të Manhattan, Bronx, Brooklyn dhe New Jersey, midis territoreve të tjera. Fillimisht drejtohej nga Lucky Luciano dhe njihej si familja Luciano. Vito Genovese u bë shefi i familjes në vitin 1957. Organizata ishte veçanërisht aktive në trafikimin e lëndëve narkotike. Më e vjetra

dhe më e madhja nga Pesë Familjet, sipas FBI-së, familja Genovese mbetet organizata më e fuqishme e krimit të organizuar në vend.

Lucchese

Familja Lucchese operon kryesisht në pjesë të Bronx, Manhattan, Brooklyn dhe New Jersey. Kushdo që e ka parë filmin *Goodfellas* do të njohë disa nga anëtarët e jetës reale të familjes Lucchese. Ata përfshinin Henry Hill dhe James 'Jimmy the Gent' Burke, të cilët organizuan grabitjen famëkeqe 5 milionë dollarëshe të Lufthansas në aeroportin JFK të Nju Jorkut.

Ndikimi i pesë familjeve

Pesë Familjet ishin më aktive në vitet 1940 dhe 1950, por dominimi i tyre vazhdoi deri në vitet 1960. Ato ushtronin pushtet mbi politikanët dhe sindikatat, si dhe industri të ndryshme, duke përfshirë argëtimin, ndërtimin dhe depozitimin e mbeturinave. Aktivitetet e tyre kriminale përfshinin huadhënien, lojërat e fatit dhe prostitucionin. Ato gjithashtu zhvasnin para "mbrojtjeje" nga pronarët e bizneseve dhe ishin aktive në

tregtimin e drogës dhe llojeve të tjera të shantazhit.

Përpjekjet për t'i eliminuar

Mjeti kryesor që përdorën autoritetet për të luftuar aktivitetet e Pesë Familjeve ishte Ligji RICO. Ai u miratua në vitin 1970 për të vënë në shënjestër krimin e organizuar. RICO në thelb lejon organet e zbatimit të ligjit, që të lidhin krimet e ndryshme individuale të kryera nga organizatat mafioze me një ndërmarrje të vetme kriminale. Ai përfshin si dënimet penale, ashtu edhe dënimet civile. Një rezultat i RICO-s ishte shndërrimi i anëtarëve të mafias të nivelit më të ulët ('djemtë e mençur' ose 'shokët e mirë') në informatorë. Ata siguruan prova kundër eprorëve, në këmbim të dënimeve më të vogla dhe mbrojtjes së dëshmitarëve. Pavarësisht nga një përpjekje e përbashkët për të mbyllur Pesë Familjet, ato janë ende shumë aktive në qytetin e Nju Jorkut dhe gjetkë, me arrestime të profilit të lartë të kryera deri në vitin 2023. Megjithatë, ata janë sot më pak të fuqishëm sesa gjatë Epokës së Artë të Mafies. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sylvinho publikon listën e Shqipërisë për ndeshjet e tetorit

TIRANË, 4 TETOR - Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë dy ndeshjet e radhës në Ligën e Kombeve, ndaj Çekisë (11 tetor, "Epet Arena", 20:45) dhe Gjeorgjisë (14 tetor, "Mikheil Meskhi Stadium", 20:45). Trajneri Sylvinho ka publikuar listën me 24 lojtarë të grumbulluar për dy ndeshjet në transfertë. Në portë janë Thomas Strakosha, Elhan Kastrati dhe Alen Sherri. Në mbrojtje Elseid Hysaj, Ivan Balliu, Mario Mitaj, Andi Hadroj, Ardian Ismajli, Berat Gjimeshi, Arlind Ajeti, Marash Kumbulla dhe Enea Mihaj. Në mesfushë Ylber Ramadani, Kristjan Asllani, Amir Abrashi, Adrijon Pajaziti, Qazim Laçi, Nedim Bajrami dhe Ernest Muçi. Në sulm Jasir Asani, Taulant Seferi, Arbër Hoxha, Myrto Uzuni dhe Mirlind Daku. Grumbullimi i lojtarëve do të nisë që të dielën në Tiranë me futbollistët që do të përfundojnë më herët impenjimet me skuadrat e tyre, ndërsa grupi i lojtarëve pritet të jetë i plotë të hënën më 7 tetor. Seancat stërvitore do të



zhvillohen në "Shtëpinë e Futbollit", ndërsa të enjten kuqezinjtë do të udhëtojnë drejt Çekisë.

"Sa i përket listës, ne kemi tre lojtarë që, për fat të keq, janë dëmtuar. Manaj është një. Ai pasi u kthye bëri 42 minuta me

klubin dhe doli nga ndeshja dhe deri tani nuk është kthyer. Fola me lojtarin, por as ai as ne nuk duhet të rrezikojmë. Janë dy

lojtarë si Berisha që në stërvitje me Leccen kishte probleme me dëmtimin dhe ishte i rrezikshëm. I treti është Keidi Bare. Ai u dëmtua në shtator dhe deri tani nuk është kthyer. Folëm me doktorin Stesina. Kemi qenë në kontakt me doktorin e Zaragozës. Ai është thujse gati por, për fat të keq, asnjë prej tyre nuk është në gjendje të vijë", ka thënë trajneri i kuqezinjve. "Pajaziti është një lojtar që kemi marrë. Ai bëri një ndryshim shumë të bukur në Kroaci. Është një lojtar që më intereson shumë, se është mesfushor i cili mund të bëjë gjithçka. Abrashi është një lojtar që ka ende për të dhënë, në këtë periudhë që ka shumë ndryshime e largime natyrale lojtarësh, vijnë të rinj, Berisha, Pajaziti, ndoshta Fetaj i cili më pëlqen. Asllani e Mitaj janë të rinj, janë me ne, por edhe Muçi. Kanë nevojë për Gjimeshin, Ajeti, Abrashin. Janë lojtarë të rëndësishëm. Janë të lidhur me fanellën e të japin një dorë me përvojën e tyre. Abrashi është një lojtar të cilit i besoj 100%", ka shtuar Sylvinho.

Sot dy ndeshje në basketboll, nesër derbi Trepça - Prishtina



MITROVICË, 4 TETOR - Java e katërt e ProCredit Superligës do të sjellë përballje mjaft interesante. Ndeshja e parë e kësaj xhiro është ndërmjet Vëllaznimit dhe Proton Cable Prizrenit, ku të dy skuadrat do të luftojnë për fitore. Kuqezinjtë kanë një fitore e dy humbje, derisa prizrenasit një fitore e një humbje. Sfidë interesante është ajo mes ish-kampionëve, Pejës dhe Golden Eagle Yllit, ku të dy skuadrat veridhezi synimin e vetëm e kanë fitoren në këtë takim.

Pejanët kanë një fitore e një humbje, derisa therandasit një fitore dhe dy humbje. Derbi i kësaj xhiro është mes skuadrave rivale dhe me traditë në basketbollin e Kosovës, Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Të dy skuadrat në tri xhirot e para kanë nga dy fitore e një humbje. Mitrovicasit në edicionin e fundit fituan katër trofe, ku pikërisht në finalen e Superkupës shënuan fitore ndaj Sigal Prishtinës. Java e katërt do të mbyllet me takimin ndërmjet

Bashkimit dhe Borës. Prizrenasit janë skuadra e vetme pa humbje me tri fitore, kurse prishtinasit të vetmit pa fitore me tri humbje në tri xhirot e para.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 4

Të shtunën takohen:

17:15 Vëllaznimi - Proton Cable Prizreni
19:00 Peja - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:

17:15 Trepça - Sigal Prishtina
19:00 Bashkimi - Bora

Një vit nga anëtarësimi i Komitetit Paralimpik të Kosovës në atë ndërkombëtar

Prishtinë, 4 tetor - Komiteti Paralimpik i Kosovës ka festuar njëvjetorin e anëtarësimit në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar, një sukses ky që u cilësua historik për sportin e Kosovës.

Kryetarja e Komitetit Paralimpik të Kosovës, Njomza Emmini, ka thënë për "KosovaPress" se brenda këtij viti patën suksese të shumta, por që gjithçka kulmoi me pjesëmarrjen në Lojërat Paralimpike që u zhvilluan në

Paris, atje ku Kosova u përfaqësua nga paraatletit Grevist Bytyqi. "Një rrugë e gjatë deri në anëtarësimin e Komitetit Paralimpik të Kosovës në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar, por që sot po e festojmë njëvjetorin e pranimi tonë në organizatën më të madhe botërore, Komitetin Paralimpik Botëror. Pranimi është rezultati më i mirë që është bërë gjatë kësaj periudhe sepse ka shumë rezultate, por që dua të ndajë është pjesëmarrja e

Kosovës në Lojërat Paralimpike Parisi 2024 dhe jo vetëm me paraatletin Grevist Bytyqi, por edhe me shumë rezultate të tjera që ne si Komitet Paralimpik edhe para pranimi jemi munduar të bëjmë aktivitete në masivizimin e sportit paralimpik", ka thënë Emmini.

Emmini, gjithashtu, bëri me dije se nga tani e tutje do t'i nisin përgatitjet për Lojërat Paralimpike që zhvillohen në Los Angeles në vitin 2024.



Në Spanjë i bëjnë jehonë sulmit të Barçës: 'Tredhëmbëshi më i mirë në Evropë'

BARCELONË, 4 TETOR - Me 7 fitore, 1 barazim në 8 ndeshje, 21 pikë në total, Barcelona kryeson La Ligën. Një meritë të padiskutuar për këtë ka faza ofensive pasi ekipi i Hansi Flick ka realizuar 25 gola në 8 ndeshje, sulmi më i mirë në Spanjë. Listën e golashënuesve më të mirë e kryeson Robert Lewandowski në kuotën e 7

golave, i ndjekur nga Perez i Villarealit me 6 gola. Në podium gjemë një tjetër lojtar blaugrana, Raphinha me 5 gola. 4 gola këtë fillim sezoni ka realizuar edhe Lamine Yamal. Pikërisht ky detaj ka tërhequr edhe vëmendjen e Mundo Deportivo, me të përditshmen spanjolle që hap faqen e parë me titullin:

"Tredhëmbëshi më i mirë". Lewandowski-Raphinha-Yamal kanë shënuar të tre së bashku plot 16 gola duke qenë tredhëmbëshi më i mirë në Evropë në 5 kampionet më të rëndësishme. Treshja e Barcelonës ndiqet nga Chelsea, PSG, Real Madrid dhe Bayern Munchen. Barcelona po kalon një sezon pozitiv, por

dëmtimet e kanë kushtëzuar shumë trajnerin Hansi Flick. Sipas medieve spanjolle, me grupin priten të bashkohen shpejt edhe lojtarë si Dani Olmo, Fermin e Gavi. Me grupin së fundmi është



bashkuar De Jong, lojtar për të cilin po punojnë për ta rinovuar kontratën e tij aktuale.

Leclerc: Titulli është i mundshëm, por vetëm vitin tjetër

MONACO, 4 TETOR - Dy fitore, nëntë podiume dhe disa gara tërësisht zhgënjyese. Ky është sezoni i deritanishëm për Charles Leclerc, që ka përjetuar emocione të ndryshme gjatë sezonit 2024 të Formula 1 me makinën Ferrari.

Titulli i parë kampion me "kokëkuqen" mbetet ende një objektiv për monogaskun, por që duket i vështirë për t'u arritur këtë vit. Ndaj, Leclerc shprehet se është gati për të luftuar për titullin në vitin e ardhshëm. "Sigurisht që është e mundur. Është një proces në zhvillim të vazhdueshëm dhe qëllimi është të përmirësohemi gjithmonë. Kështu që unë do të thosha se 2025 do të jetë i mirë, 2026 do të jetë edhe më i mirë, si dhe 2027", ka thënë Leclerc. "Nuk ka një ekip që përkeqësohet nga viti në vit. Kjo varet edhe nga rritja e skuadrave të tjera. Megjithatë, nga ana jonë nuk kam asnjë dyshim. Ne do të bëjmë një hap përpara", u shpreh më tej piloti monogask i "kokëkuqes". Në këtë përmirësim do të



kontribuojë edhe prania e Hamiltonit sezonin tjetër: "Ai nuk duket të ketë ndonjë pikë të dobët. Do të jetë interesante për mua të mësoj nga Lewis, gjithashtu më motivon të tregoj se çfarë jam i aftë me të njëjtat pajisje". "Ky është një sezon vërtet i kundërt nga pikëpamja emocionale. Arrita dy fitoret që kam ëndërruar gjithmonë, në Montekarlo dhe Monza. Në të njëjtën kohë, ne kaluam një

periudhë konfigurimesh për të eksperimentuar dhe një makinë shumë të vështirë për t'u drejtuar", ka deklaruar Leclerc. "Ishte e vështirë për ta gjetur përsëri rrugën e duhur. Do të gënjeja nëse do të thosha se isha gjithmonë i sigurt për kthimin tonë, por tani po përmirësohemi garë pas gare, sezon pas sezoni. Na duhet vetëm kohë për t'i kthyer ato në përditësim për makinën", ka deklaruar Leclerc.

Fury, Usyut: Bëra një gabim në duelin e parë, në revansh do ta ndiesh gjithë zemërimin tim

LONDËR, 4 TETOR - Tyson Fury postoi së fundi një mesazh në "Instagram", duke i thënë kampionit të unifikuar të peshave të rënda, ukrainasit Oleksandr Usyk, se ai bëri një "gabim" në përballjen e parë mes tyre në maj të këtij viti. Boksieri britanik shprehet i penduar që nuk e përfundoi me sukses misionin e tij në sfidën që ata patën në Arabi, duke pësuar humbjen e parë në karrierë (numëron 34 fitore, 1 humbje e 1 barazim). Për pasojë, Fury i shkruan Usyk (22 fitore e asnjë humbje) se do ta ndiejë gjithë zemërimin e tij në revanshin që ata do të zhvillojnë më 21 dhjetor po në Riad. Ai shkruan se "mbreti cigan" është ringjallur. Fury është përpjekur të kuptojë se çfarë shkoi keq dhe kuptoi se e kaloi pjesën më të madhe të duelit me Usyk duke u mbështetur me shpinën kundër



litarëve. Ai përdori të njëjtën strategji si në sfidën kundër Wladimir Klitschko në vitin 2015. Dallimi ishte se Usyk nuk kishte frikë ta godiste dhe ia doli mbanë atë natë. "Unë e godita, por nuk munda ta mbaroj punën! Gabim. Tani do ta ndiesh zemërimin e një kërcënimi", ka thënë Tyson Fury në

"Instagram", duke i dërguar një mesazh Oleksandr Usyk. "Gypsy King 2024 po vjen për ju. 21 dhjetori është imi kundër botës. Do të jem kampioni i ardhshëm i peshave të rënda në tri kategori", ka shtuar Fury, që pritet të ndryshojë formë dhe strategji për revanshin, siç bëri ndaj Wilderit.

SHKURT

KB Peja rikthen basketbollistin Tervell Beck

KB Peja e ka rikthyer në skuadër basketbollistin Tervell Beck. Kjo u bë me dije nga klubi pejan përmes një njoftimi në faqen në "Facebook". Beck ishte pjesë e Pejës edhe sezonin e kaluar. "Ju njoftojmë se KB Peja ka arritur marrëveshje me Tervell Beck për rikthimin e tij në skuadrën tonë. Beck ishte pjesë e Pejës edhe sezonin e kaluar. Basketbollisti pritet të udhëtojë nga Izraeli ditën e diel, ku po largohet pas situatës së komplikuar - për t'u bashkuar me Pejën duke filluar aventurën e dytë me ngjyrat verdhezi", ka njoftuar skuadra pejane.

Xhaka: Respekt për Kielin, presim tri pikë

Bayer Leverkuseni do të kërkojë tri pikët ndaj Holstein Kiel, takim ky që do të luhet për kampionatin gjerman. Në prag të kësaj sfide, mesfushori shqiptar i kampionëve të Gjermanisë, Granit Xhaka, ka thënë se skuadra duhet të japë më të mirën në fushë, pasi vetëm kështu mund të fitojë. "Nëse kemi ndjenjën se mund të fitojmë të shtunën vetëm duke dhënë 70 për qind, kjo do të jetë e gabuar. Ne respektojmë çdo kundërshtar. Të gjithë kanë cilësitë e tyre, të mirat dhe këqijat, qoftë Milani, Bayerni apo Kieli", ka thënë Xhaka për "Kicker". "Nuk duhet ta nënvlerësojmë kundërshtarin. Kjo ishte edhe arma jonë në sezonin e kaluar. Nuk jam shumë i shqetësuar për këtë sepse kemi mjaft lojtarë me përvojë", ka shtuar Xhaka.

Transferimet e lojtarëve, FIFA shton një tjetër afat për klubet

FIFA pritet që shumë shpejt të shtojë një tjetër afat për transferimin e lojtarëve. Bëhet fjalë për 10 ditët e para të qershorit, që do të jenë në dispozicion vetëm të klubeve që marrin pjesë në Kupën e Botës për klube. Format i ri do të shohë 32 skuadra të marrin pjesë. Po ashtu, do të luhet çdo 4 vjet dhe jo çdo sezon. Në anën tjetër nuk do të zhvillohet sërish në dhjetor, por në verë. Ky kompeticion zgjat nga 15 qershori deri më 13 korrik. Për këtë ishte e nevojshme të shtohet një tjetër dritare transferimesh për shkak se shumë prej lojtarëve i kanë kontratat e vlefshme deri më 30 qershor.

Ten Hag: Më gjykoni në fund të sezonit

Manchester City barazoi me Porton (3-3), derisa trajneri Erik ten Hag ka kërkuar që t'i jepet afat deri në fund të sezonit dhe mos të kritikohet tash. "Ne do të arrijmë atje, mos na gjykoni në këtë moment. Na gjykoni në fund të sezonit. Ne do të përmirësohemi, kemi dy sezone ku arritëm finalen. Vetëm prisni, ne do ta zhvillojmë dhe do ta përparojmë këtë ekip", ka thënë Ten Hag, i cili e ka mbrojtur ashpër rekordin e tij pasi fitoi Kupën e Ligës dhe FA Cup në dy sezonet e tij të para në "Old Trafford" - duke i dhënë fund mungesës gjashtëvjeçare pa trofe të Unitedi.

Lukaku: Te Napoli ndien se futbolli është një 'fe'

Romelu Lukaku është kthyer në idhullin e ri të skuadrës së Napolit, që kryeson renditjen e Serisë A. Ekipi i trajnerit Antonio Conte do të luajë ndaj Comos dhe sulmuesi belg synon të jetë protagonist në fushë. "Para se të vija te Napoli

folamë me Dries Mertens, të cilin e njoh që kur isha 17-vjeçar. Ai ishte personi im i besuar që më përgatiti për Napolin", u shpreh Lukaku. Ai foli lidhur me përshtatjen e tij në Napoli, skuadër ku erdhi në momentet e fundit të merkatos, kur kishte

nisur kampionati. "Vërej se çdo napolitan ndien se përfaqëson një popull të tërë. Kjo më transmeton energji çdo ditë, më bën të ndihem mirë dhe më bën të ndihem edhe më përgjegjës", tha Lukaku. "Ndjeva menjëherë

ngrohtësinë e fansave. Ata më dhanë shumë energji pozitive dhe shënova një gol në debutimin tim, mbi të gjitha fituam, që është gjëja më e rëndësishme", u shpreh sulmuesi belg. Në lidhje me objektivat e tij dhe të ekipit,

Lukaku ka deklaruar: "Çdo ditë përpiqem të jap gjithmonë diçka më shumë. Gjatë sezonit duhet të bësh dhjetë muaj sakrificë, të japësh 100 % dhe në fund do t'i shohësh rezultatet. Ky është mentaliteti im".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details


Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SOREN ART BAR" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 812058198 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SOREN ART BAR" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812058198 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "SOREN ART BAR" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812058198 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valbone Zhubi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Sylejman Sejda shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Arzu Bulut shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Dimal Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Dëshmorët e Hasit" Kabash, Has.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti,
- banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

